

VENDIM
Nr. 289, datë 10.5.2019

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
FINANCIVE DHE EKONOMISË TË PASURISË ME NUMËR 33/76, ZONA
KADASTRALE 8523, ME SIPËRFAQE TRUALLI 7 726 m² DHE SIPËRFAQE
NDËRTESE 7 307 m², ME VENDNDODHJE NË ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 10 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të pasurisë me numër 33/76, zona kadastrale 8523, me sipërfaqe trualli 7 726 m² (shtatë mijë e shtatëqind e njëzet e gjashtë) dhe sipërfaqe ndërtese 7 307 m² (shtatë mijë e treqind e shtatë), pronë shtet, me vendndodhje në Elbasan, sipas kartelës së pasurisë dhe hartës treguese, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

239
26.03.19

D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE,
SERVITUTAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

Nr. Dok	Data e Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. të Çertifikatës	Shënime	Firma

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj.

Nr. Dok	Data e Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. të Çertifikatës	Shënime	Firma

HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

